



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.396/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët Hidajete Gashi Alaj - kryesuese, Ramush Bardiqi dhe Arsim Hamzaj, anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/3093-2025 i datës 03.11.2025 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendet Komunale të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 07.11.2025, merr këtë,

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZL.Anr.396/2025, e datës 05.11.2025, e parashtruar nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/3093-2025 i datës 03.11.2025 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale në Republikën e Kosovës për Kuvendet Komunale të mbajtura me datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Më datë 05.11.2025, PZAP-i ka pranuar ankesën ZL.Anr.411/2025, nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së të datës 03.11.2025 për miratimin e Rezultateve Përfundimtare të Zgjedhjeve Lokale për Kuvendin e Komunës së Prizrenit, të cilat u mbajtën më 12.10.2025, në të cilën thekson se ka shkelje thelbësore të dispozitave të nenit 3 të ligjit nr. 03/l/72 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, neni 2, shkelje e nenit 32, kapitulli v. Kodi i Sjelljes për Subjektet Politike, mbështetësit e tyre dhe kandidatëve, neni 33. Përgjegjësitë e partive politike, mbështetësve dhe kandidatëve të tyre, neni 34. Veprimet e ndaluara të subjekteve të politike.

Parashtruesja e ankesës thekson se, në zgjedhjet lokale të mbajtura në Republikën e Kosovës më 12 tetor 2025, subjektet politike Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), Vetëvendosje (VV), Partia Demokratike e Kosovës (PDK), Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) të gjitha partitë politike të regjistruara që morën pjesë në zgjedhjet lokale në vitin 2025 në Komunën e Prizrenit dhe në fshatrat boshnjake arritën shumicën e votave, në një mënyrë të tillë që në fushatën parazgjedhore me veprime të ndaluara, subjektet politike të lartpërmendura,

mbështetësit dhe kandidatët e tyre, paraqitën me vetëdije sjelljen e tyre dhe krijuan kushte në të cilat qytetarët - votuesit e Komunitetit Boshnjakë nga vendbanimet dhe fshatrat në rajonin e fshatrave Zhupa dhe Podgora: Planjan, Rečana, Lokvica, Nebregoshte dhe vende të tjera nuk mundën të zgjedhin përfaqësuesit e tyre përmes zgjedhjeve të lira, të ndershme dhe të informuara mirë në frymën e tolerancës demokratike, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit. Në këtë mënyrë, subjektet politike të lartpërmendura, nëpërmjet akteve të frikësimit dhe dhunës gjatë fushatës parazgjedhore dhe procesit zgjedhor, përdorën presion, kërcënime dhe përdorimin e premtimeve të rreme të çdo lloji nga subjektet politike, anëtarët, mbështetësit ose kandidatët e tyre, si dhe shpërndarja e parave për të fituar mbështetjen e votuesve. Veprimet e lartpërmendura në fushatën parazgjedhore dhe gjatë zgjedhjeve të subjekteve politike të lartpërmendura shkelën Kushtetutën e Republikës së Kosovës. Duke pasur parasysh që të gjitha këto parti politike të regjistruara që morën pjesë në zgjedhjet lokale të vitit 2025, në Komunën e Prizrenit dhe në fshatrat boshnjake arritën shumicën e votave. Dhe për këto arsye, kjo ankesë paraqitet për të mbrojtur të drejtën themelore kushtetuese të komunitetit boshnjak si komunitet jo-shumicë në territorin e Republikës së Kosovës, dhe veçanërisht në Komunën e Prizrenit, për të zgjedhur dhe për t'u zgjedhur përmes përfaqësuesve të saj legjitimë politikë që shprehin vullnetin e atij komuniteti. Si pasojë e veprimeve të paligjshme të partive të lartpërmendura shqiptare. Në zgjedhjet lokale të mbajtura më 12 tetor 2025, ku në disa fshatra jetojnë vetëm anëtarët e komunitetit boshnjakë (Zhupa, Podgor , Planjanë , etj.), u regjistruan rezultate sipas të cilave partitë politike shqiptare morën më shumë se 50% të votave edhe pse ato as nuk i përfaqësojnë, dhe as nuk i kanë përfaqësuar ndonjëherë, interesat e atij komuniteti. Sipas të dhënave paraprake dhe përfundimtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, në fshatrat Planjanë , Reçane , Nebregoshtë dhe vendbanime të tjera me pothuajse 100% popullsi boshnjake, partitë LDK dhe VV morën shumicën e votave. Sipas parashtruesit të ankesës ekziston dyshimi i bazuar mirë se votat janë fituar nëpërmjet presionit, blerjes sistematike të votave dhe ndikimit të paligjshëm mbi votuesit e komunitetit boshnjak , gjë që shkel parimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme nga neni 3 i Ligjit për Zgjedhjet Lokale nr. 03/L-072. Rezultate të tilla pengojnë përfaqësimin autentik politik të komunitetit boshnjak dhe krijojnë një precedent në të cilin komuniteti jo-shumicë humbet mundësinë për të zgjedhur përfaqësuesit e vet. Rasti është analog me vendimin e Gjykatës Supreme të Kosovës në rastin e Andrijana Hodžić (2021), kur mandatet e fituara me votat e të gjithë komunitetit iu hoqën, sepse ato nuk shprehnin vullnetin e komunitetit që kandidati përfaqësonte zyrtarisht. Andaj i njëjti kërkon që të përcaktohet paligjshmëria dhe parregullsia e votimit në qendrat e votimit boshnjake fshatrat e komunës së Prizrenit, të anulohen rezultatet e zgjedhjeve në qendrat e votimit të përmendura dhe të urdhërohet përsëritja e zgjedhjeve nën mbikëqyrjen e institucioneve të pavarura dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, të detyrojë Komisionin Qendror të Zgjedhjeve të marrë masa të posaçme për të mbrojtur komunitetet jo-shumicë (qendra të posaçme votimi, trajnim dygjuhësh të zyrtarëve, mbikëqyrje të vëzhguesve të paanshëm) në ciklet e ardhshme zgjedhore, të urdhërohen subjektet politike të paditura të përmbahen nga çdo fushatë dhe aktivitete që ndikon në votat e komuniteteve që nuk i përfaqësojnë, të urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që të informojë Gjykatën Kushtetuese dhe Avokatin e Popullit për këtë rast. Si dëshmi i përmend rezultatet zyrtare të KQZ-së sipas qendrave të votimit (Zhupa, Podgor, Planjane, etj.), deklaratat e qytetarëve për ushtrim presioni dhe ofrim parash në këmbim të votave; Rezultate krahasuese nga zgjedhjet e mëparshme (2017, 2021) për të vërtetuar ndryshimet e papritura dhe të palogjikshme në vota; Vendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës në rastin Andrijana Hoxhiq kundër KQZ (A. nr. 20/2021); Raport statistikor mbi strukturën etnike të fshatrave (nga Regjistrimi i vitit 2011 dhe të dhënat lokale). E njëjta thekson se kjo padi synon të mbrojtë të

drejtën kushtetuese të komunitetit boshnjak për të zgjedhur lirisht përfaqësuesit e tij dhe që votat e tij të mos jenë subjekt i tregtisë apo manipulimit. Nëse një praktikë e tillë nuk sanksionohet, ajo çon në fshirjen de facto të komunitetit boshnjak nga jeta politike e Prizrenit. Andaj kërkojnë që të miratohet kjo ankesë dhe do të anulohen rezultatet e parregullta, si dhe do të urdhërojnë përsëritjen e zgjedhjeve në fshatrat e diskutueshme.

Në përgjigjen në ankesë KQZ-ja lidhur me pretendimet e palës ankuese ka theksuar se, liria dhe e drejta e votës në Republikën e Kosovës janë të garantuara me Kushtetutë dhe me ligjet që rregullojnë proceset zgjedhore. Këto të drejta bazohen në Parimin e barazisë së qytetarëve dhe komuniteteve, që është një nga shtyllat themelore të rendit kushtetues të Kosovës. Pretendimet e palës ankuese nuk qëndrojnë sepse në fletëvotim nuk mund të identifikohet emri i votuesit e as përkatësia etnike e votuesit. Në lidhje me pretendimet e palës për shkeljet nga subjektet e lartpërmendura për të cilat pretendohet nga pala ankuese që ato subjekte kanë përdorur frikësime dhe dhunë gjatë fushatës zgjedhore dhe procesit zgjedhor si dhe kanë përdorur presion, kërcënime, premtime të rrejshme të të gjitha llojeve dhe kanë ndarë para për t'i përfituar votuesit, këto raste nuk janë raportuar nga KKZ në Prizren, e as në Dhomën Operative të KQZ-së në ditën e zgjedhjeve. Duke marrë parasysh se këto parregullsi të pretenduara, kanë të bëjnë me ditën e zgjedhjeve, atëherë ankesa është e pasafatshme, sepse afati për parashtrimin e ankesave që lidhen me ditën e zgjedhjeve, duhet të parashtrohen në PZAP 48 orë pas mbylljes së Qendrave të Votimit.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë, ka gjetur se:

Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet e parashtrueses së ankesës e cila pretendon se, ka pasur parregullsi gjatë procesit të votimit në vendvotime në fshatrat me shumicë të Komunitetit Boshnjak në Komunën e Prizrenit për shkak se subjektet politike shqiptare, LDK, LVV, PDK, dhe AAK kanë më shumë vota dhe se subjektet e lartpërmendura gjatë fushatës zgjedhore dhe procesit zgjedhor kanë përdorur presion, kërcënime, premtime të rrejshme dhe kanë ndarë para për t'i përfituar votuesit, për Panelin këto pretendime janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga pretendimet e theksuara në ankesë paneli nuk ka arritur që të vërtetojë se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pretendon pala ankuese me ankesën e saj, kjo pasi që ankuesja në ankesën e saj nuk i ka bashkangjitur asnjë provë të vetme dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e saj dhe se pretendime e theksuara në ankesë tani për tani mbeten në nivel të supozimit nga se nuk janë argumentuar me fakte dhe prova konkrete.

Sa i përket pretendimit ankimor me të cilin pretendohet se është përdorur presion dhe kërcënime nga subjektet politike shqiptare, LDK, LVV, PDK, dhe AAK si dhe arsyetimi se të njëjtit kanë ndarë para për t'i përfituar votuesit duke ndikuar direkt në rezultatin e votimit, Paneli, vlerëson se, parashtruesja e ankesës në mbështetje të pretendimeve të saj nuk ka ofruar asnjë dëshmi dhe prova bindëse lidhur me shkeljet e supozuara, edhe pse në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP-së, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në rastin konkret, kjo vërtetohet edhe nga përgjigja e KQZ-se e cila thekson se lidhur me këto pretendime nuk janë raportuar në KKZ në Prizren, e as në Dhomën Operative të KQZ-së në asnjë moment gjatë procesit zgjedhor lidhur me pretendimet e tilla, andaj bazuar në të gjitha këto Paneli ka vendosur që të refuzoj të pabazuar ankesën e ankueses.

Paneli vlerëson se, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të palës ankuese për faktin se nuk mund të vërtetohet se ka pasur manipulime të votave gjegjësisht se të njëjtat janë orkestruar ashtu siç pretendon pala ankuese, kjo pasi që Paneli, nuk mundi të vërtetoj një pretendim të tillë për faktin pala ankuese pretendimet e saj nuk i ka mbështetur me asnjë provë të vetme dhe se pritshmëritë e ankuses nuk nënkupton se automatikisht subjekti i saj politik kishte me marrë vota më shumë.

Lidhur me pretendimet e palës ankuese se gjatë procesit të votimit subjektet politike shqiptare, LDK, LVV, PDK, dhe AAK kanë më shumë vota në fshatrat me shumicë të Komunitetit Boshnjak dhe vendbanime të tjera me pothuajse 100% popullsi boshnjake, Paneli vlerëson se sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnicitetin e votuesve përkatësisht të votimit. Andaj për Panelin këto pretendime janë ta pabazuara duke iu referuar nenit 6 par. 2 i LZP-së, që parasheh se “Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë”, duke mos paragjykuar se si një votues zgjedhë të votojë një subjekt politik të caktuar”.

Paneli sqaron se, për një situatë të tillë, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës me Aktgjykimin në rastin KI69/2021, në pikën 196 ka theksuar se: “Bazuar në sqarimet e lartcekura, në kuadër të sistemit aktual zgjedhor në Republikën e Kosovës nuk ka asnjë bazë mbi bazën e të cilës do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotime në vendvotime të caktuara duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklarohet që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Gjykata rikujton që sipas GJENDJ-së (i) nuk është detyrë e gjykatave që të përcaktojnë vullnetin e votuesve, përfshirë përmes shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë dhe (ii) çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullativa e KQZ-së në kontekst të kompetencës së PZAP-së, për të anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotime.” Ndërsa në pikën 198 të këtij aktgjykimi është konstatuar se: “Përfundimisht, Gjykata rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të votuesit.”

Po ashtu me dispozitën e nenit 45.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është paraparë që: “Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh që: ”Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.” Në rastin konkret Paneli nuk mund të pranojë një pretendim dhe një kërkesë të tillë që të anulohen zgjedhjet dhe të shpallen të pavlefshme fletëvotimeve pa bazë të saktë ligjore, pasi që çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar dhe të ketë mbështetje ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe rregullativa e KQZ-së, për të anuluar zgjedhjet /dhe për të shpallur të pavlefshme fletëvotime.

Paneli rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të

votuesit, sepse as Ligji dhe as Rregullativa e KQZ-së, nuk përcaktojnë asnjë kriter tjetër mbi bazën e të cilit mund të shpallen të pavlefshme fletëvotimet dhe aq më pak kriter të bazuar në përkatësi etnike të votuesve.

Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), është e pabazuar pasi që nuk ka bashkangjitur prova bindëse që do të dëshmonte pretendimet ankimore. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*". Andaj, Paneli e refuzoi ankesën pasi që pala ankuese nuk e bëri të besueshme me prova bindëse dhe nuk ka mundur të vërtetoj se votat për komunitetin boshnjak janë të manipuluar dhe të orkestruara, por se theksimet e saj në ankesë janë vetëm deklarime dhe të pa argumentuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.396/2025 më datën 07.11.2025

Kryesues i Panelit
Hidajete Gashi Alaj



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.